

20120842209

L I G J
PËR PLOTESIMIN E LIGJIT PËR REZERVA TË DETYRUESHME TË NAFTAES DHE
DERIVATEVE TË NAFTAES

Neni 1

Në Ligjin për rezerva të detyrueshme të naftes dhe derivateve të naftes ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonise" numer 84/2008 dhe 35/11), pas nenit 9 shtohet nen i ri 9-a, si vijon:

"Neni 9-a

(1) Rezervat e detyrueshme të derivateve të naftes mund të shfrytëzohen edhe në gjendje krize, si dhe në raste tjera kur ekziston nevojë urgjente për derivate të naftes nga organe shtetërore, ndermarrje publike, institucione publike dhe persona dhe institucione tjera juridike të themeluara nga shteti që kryejnë veprimtari me interes publik dhe komunat, për kryerjen e aktiviteteve të tyre të percaktuara me ligj.

(2) Shfrytëzimi i rezervave të detyrueshme në gjendje krize kryhet me leshim të huave afatshkurta të llojeve të vecanta të derivateve të naftes, organeve dhe institucioneve shtetërore të ngarkuara për ballafaqim me gjendje krize.

(3) Huat afatshkurta nga paragrafi (2) i këtij neni, mund të jene në sasi që gjatë vitit kalendarik nuk do të tejkalojnë 50% nga sasite e përgjithshme të depozituara të rezervave të detyrueshme për çdo derivat të naftes veç e veç.

(4) Shfrytëzimi i rezervave të detyrueshme në rastet tjera kur ekziston nevojë urgjente për derivate të naftes për kryerje të punëve nga kompetenca e tyre të percaktuara me ligj, kryhet me leshim të huave afatshkurta apo me leshim pa kompensim të llojeve të vecanta të derivateve të naftes nga rezervat e detyrueshme, organeve shtetërore, ndermarrjeve publike, institucioneve publike dhe personave dhe institucioneve tjera juridike të themeluara nga shteti që kryejnë veprimtari me interes publik si dhe komunave.

(5) Derivatet e leshuara të naftes nga paragrafi (4) i këtij neni, mund të jene në sasi që gjatë vitit kalendarik nuk do të tejkalojnë 25% nga sasite e përgjithshme të depozituara të rezervave të detyrueshme për çdo derivat të naftes veç e veç.

(6) Për shfrytëzuesit, shpenzimet për dërgim, llojin, sasite dhe dedikimin e derivateve të naftes që huazohen apo leshohen pa kompensim, si dhe për afatin për kthimin e sasive të huazuara në rastet nga paragrafet (2) dhe (4) të këtij neni, vendos Qeveria e Republikës së Maqedonise."

Neni 2

Dispozitat e nenit 1 të këtij ligji do të zbatohen deri në ditën e aderimit të Republikës së Maqedonise në Bashkimin Evropian.

Neni 3

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e tete nga dita e botimit në "Gazeten Zyrtare të Republikës së Maqedonise".